

## ABSTRAKT

Trajtimi i pozitë kushtetuese të komuniteteve jo shumicë duke bërë analizë krahasuese kushtetuese në shtetet: Republika e Kosovës, Maqedoninë e Veriut dhe Luginën e Preshevës është shumë me rëndësi sidomos në kohën e sotme ku shumë organizata dhe instrumente ndërkombëtare merren me çështjen e pozitës kushtetuese të komuniteteve jo shumicë apo më saktësisht me të drejtat që i gëzojnë komunitetet jo shumicë në vende të ndryshme.

Komunitetet jo shumicë në Republikën e Kosovës janë komunitetet më të privilegjuar, të cilët gëzojnë të drejta dhe përfaqësim shumë më të mirë në krahasim me popujt e tjerë të rajonit, të cilët nuk e kanë këtë pozitë të mirë kushtetuese.

Republika e Kosovës ka treguar se i respekton me përpikmëri zotimet që i ka marrë në realizimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, si dhe duke u mundësuar atyre përfaqësim në çdo institucion publik, si në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe atë gjyqësor, por edhe në nivel lokal.

**Fjalët kyçe:** Kushtetuta, Ligji, Komunitetet jo shumicë, Pakicë kombëtare, Popull shtetformues, Qeveria, Kuvendi dhe Gjykata.